



REPUBLIKA E SHQI
AVOKATI I POPU _____
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701075/8

Tiranë ___/___/2018

Lënda : Dërgohet Rekomandim "Për marrjen e masave nga ana e Bashkisë Krujë, për përcjelljen për rregjistrim në ZVRPP Krujë të AMTP-ve nr. 303, 304, 305, datë 25.07.1993".

Drejtuar : Kryetarit të Bashkisë Krujë
Z. Artur Bushi

KRUJË

Për dijeni : Regjistruerit të ZVRPP, Krujë

KRUJË

I nderuar z. Kryetar,

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim ankesën e paraqitur nga qytetarët z. B.S, N.Sh dhe R.Sh (trashëgimtar i të ndjerit S.Sh), të cilët kanë ngitur shqetesimin e tyre dhe janë ankuar në zyrën e Avokatit të Popullit për mosdërgimin në ZVRPP Krujë, nga ana e Bashkisë Krujë, të AMTP me nr. 303, 304, 305, datë 25.07.1993, lëshuar në emrat e tyre bazuar në ligj dhe aktet nënligjore në fuqi, nga organi kompetent i kohës së ndarjes së tokave në fshatin Borizanë.

Ankuesit pretendojnë se nga ana e Bashkisë që ju drejtoni, këto akte nuk janë përcjelle për rregjistrim Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme, Krujë, sikurse parashikon Vendimi i Keshillit të Ministrave nr. 994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi", i ndryshuar.

Konkretisht, referuar procedurave të parashikuara në VKM Nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi", subjektet B.Sh, N.Sh dhe R.Sh kanë aplikuar pranë ZVRPP Krujë për regjistrimin e AMTP-ve në regjistrin hipotekor të pasurive të palujtshme. Nga ana e ZVRPP Krujë, në përgjigje të aplikimit drejtuar subjekteve të interesuara shprehet se, nga verifikimi në arshivën e kësaj zyre, nuk rezultojnë të jenë depozituar kopjet origjinale të AMTP nr. 303, 304, 305, datë 25.07.1993. Ndaj, ZVRPP Krujë ka orientuar këto subjekte të drejtohen

Bashkia Krujë për përcjelljen zyrtare e kopjeve origjinale të AMTP-ve të lartpërmendura, sikurse përcaktohet në VKM Nr. 994, datë 9.12.2015.

Në këto kushte, subjektet e interesuara janë drejtuar me kërkesë Bashkia Krujë për të vijuar me procedurat e plotësimit dhe përcjelljen e dokumentacionit ligjor pranë ZVRPP Krujë, të AMTP-ve nr. 303, 304, 305, datë 25.07.1993, me qëllim regjistrimin dhe pajisjen e tyre me dokument pronësie. Por, nga ana e Bashkia Krujë, kërkesa e subjekteve në emër të të cilave janë lëshuar AMTP e lartpërmendura, është refuzuar dhe dokumentacioni mbahet ende në arshivën e kësaj Bashkie në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi, si dhe vendimet e gjykatave të shprehura për këtë qëllim.

Institucioni Avokatit të Popullit, pasi u njoh me ankesën dhe dokumentacionin e depozituar nga shtetasit B.Sh, N.Sh dhe R.Sh, filloj procedurën për shqyrtimin e saj, me kërkesën drejtuar Bashkia Krujë me shkresë Nr.K3/B21-2 prot., datë 05.09.2017, për informacion dhe shpjegime lidhur me shkaqet ligjore që justifikojnë organin që ju drejtoni, për mosdërgimin e dokumentacionit ligjor të AMTP nr. 303, 304, 305, datë 25.07.1993, për regjistrim pranë ZVRPP Krujë.

Bashkia Krujë, në përgjigje të kërkesës tonë, me shkresë Nr.5310/1 datë 20.09.2017 informon se, toka e përfshirë në AMTP-të e këtyre subjekteve është sipërfaqe që ndodhet nën serë, e cila është privatizuar sipas legjislacionit në fuqi të kohës, nga shtetasi F.Sh me Akt Shitje-Blerje datë 19.11.1991 nga Komisioni i ndarjes të pasurisë së Kooperativës Bujqësore Borizanë, në zbatim të VKM nr.255 datë 28.01.1991 dhe Udhëzimit nr.5 datë 08.08.1991 të Ministrisë së Bujqësisë.

Ndërkohë, pavarësisht kësaj përgjigje, Bashkia Krujë me shkresë Nr.6203 prot., datë 20.10.2017 është drejtuar me kërkesë Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Durrës, për shprehjen e vlefshmërisë ligjore të AMTP-ve nr. 303, 304, 305, datë 25.07.1993, në emër të pjestarëve të familjes “Sh”.

Institucioni Avokatit të Popullit, duke qënë se, ishte përfshirë në procesin e shqyrtimit të kësaj ankese, për vetë trajtimin ligjor të saj, ju drejtua me kërkesë Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Durrës me shkresë Nr.K3/B21-5 prot., datë 30.10.2017, për dërgimin e kopje të vendimit të këtij komisioni, për shprehjen e vlefshmërisë ligjore të AMTP-ve nr. 303, 304, 305, datë 25.07.1993, në bazë të kërkesës dërguar nga Bashkia Krujë.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Komisionin e Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, Durrës, me shkresën nr. 2240/1 prot, datë 18.12.2017, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, firmosur nga prefekti z. Roland Nasto, thuhet shprehimisht se: *“Për çështjen në fjalë ekzistojnë disa vendime gjykate të formës së prerë, përkatësisht vendimi nr.12 datë 16.01.1993 të Gjykatës së Rrethit Krujë, vendimi nr.510 datë 29.06.1995 i Gjykatës së Rrethit Krujë, vendimi nr.4328 datë 25.10.1995 i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimi nr.156 datë 09.02.1996 i Gjykatës së Kasacionit Tiranë”*.

Në përfundim të përgjigjes, Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës shprehet se:
“Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nuk ka kompetencën ligjore të shprehet për çështje për të cilat është marrë vendim i formës së prerë nga gjykata”.

I nderuar z. Kryetar,

Përsa më sipër, pas hetimit administrativ të bërë nga ana jonë, konsatojmë në vijim të shqyrtimit, komunikimit dhe korespondencës me organet shtetërore të ngarkuara me Ligj nr. 9948, date 07.07.2008 *“Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë”*, si dhe akteve nënligjore për rregjistrimin e AMTP-ve, konstatojmë se, nuk ka asnjë vendim të KVVTP pranë Prefektit të Qarkut Durrës, për shfuqizimin e AMTP-ve nr.303, 304, dhe 306 datë 25.11.1993.

Po ti referohemi, vendimeve të gjykatave të sipërcituara, vendimi nr.12 datë 16.01.1993 të Gjykatës së Rrethit Krujë, kundër këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata Apelit Tiranë me vendimin e saj nr.163, datë 27.02.1993 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit civil të Gjykatës së Rrethit Krujë nr.12 datë 16.01.1993, në pjesën që rrezon padinë për pushim cënim pronësie. Prishjen e këtij vendimi dhe **pushimin e gjyqimit në pjesën që anulon aktet e pronësisë nr. 303, 304, dhe 306 datë 25.11.1993 që u përkasin paditësve B.Sh, N.Sh dhe R.Sh”.***

Ndërkohë, vendimi nr.510 datë 29.06.1995 i Gjykatës së Rrethit Krujë, vendimi nr.4328 datë 25.10.1995 i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimi nr.156 datë 09.02.1996 i Gjykatës së Kasacionit Tiranë”, me objekt *“Pavlefshmëria e kontratës së shitjes të një sere në Borizanë, Krujë”*, me palë paditës: Seksioni i Kontroll Revizionit pranë Bashkisë Krujë, i paditur: Komisioni i Ndarjes të Pasurive të Kooperativës Bujqësore Borizanë, person i interesuar: B.Sh, N.Sh dhe R.Sh dhe Banka Bujqësore Krujë kanë vendosur: *“Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj e në prova....”*. Pra, që nënkupton rrëzimin e kërkesës padisë përpara i takon pavlefshmërisë të kontratës të shitjes të serës dhe nuk është shprehur në asnjë prej këtyre vendimeve për çështjen e AMTP-ve.

Ndodhur në këto kushte, bazuar dhe në dokumentacionin e administruar në dosjen që ndodhet në zyrën tonë gjykojmë se, nuk ka pengesa ligjore për përcjelljen për regjistrim të AMTP-ve të mësipërme për ankuesit në fjalë në ZVRPP Krujë.

Lidhur me procedure e dërgimit për regjistrim të këtyre titujve, ankuesit pretendojnë se aktet në fjale janë dërguar fillimisht nga ana juaj për regjistrim me shkresën nr. 2954/1, datë 12.07.2016, “Dërgim dokumentacioni”, shoqeruar me 7 dokumenta të listuara në shkresë, firmosur në mungesë dhe me porosi nga N/Kryetari i Bashkisë z. Rrahman Rraja në emër të Kryetarit, janë tërhequr sipas ankuesve po nga Bashkia në rrethana të pa qarta për tu kuptuar sipas tyre, më datë 11.08.2016, veprim i cili ka ndërprerë procedurën e regjistrimit në fjalë në ZVRPP Krujë.

Ankuesit pretendojnë vetëm pronësinë e tokës sipas AMTP-ve të cituara me lart, përfituar në bazë të ligjit nr. 7051, date 19.07.1991 *“Për Token”*, i ndryshuar dhe VKM nr. 255, date 02.08.1991 *“Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”*, i ndryshuar.

Mbi bazen e dokumentacionit të paraqitur pranë zyrës tonë, i cili shoqëron ankesat e shtetasve në fjale konstatohet se AMTP-të e cituara më lart në emër të ankuesve, nëse janë tërhequr nga ana juaj, sikurse shprehen ankuesit, duhet te përcillen për regjistrim konform VKM nr. 994, date 09.12.2015 *“Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”*, i ndryshuar, ku trajtohen AMTP-të e lëshuara nga Komisionet e Ndarjes së Tokës, përpara datës 15.08.2008. Në këtë vendim gjithashtu sanksionohet në pikën c) *“AMTP-ja të përcillet zyrtarisht për rregjistrim nga njësia e qeverisjes vendore”*.

Gjithashtu në vijim, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ankuesit para zyrës tonë nuk konstatohet ndonjë paregullsi për trajtimin me tokë bujqësore të ankuesve nga Komisioni i ndarjes së tokës në fshatin Borizanë, banorë të cilit kanë qenë dhe ankuesit në fjalë, në kohën e ndarjes së tokës, gjithashtu dhe paisja me AMTP e ankuesve është bërë në vitin 1993, kohë kur dhe është bërë ndarja e tokës në atë fshat.

Referuar ligjin nr. 9948, date 07.07.2008 *“Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë”*, neni 4, thuhet shprehimisht se: ***“Dhënia e tokës bujqësore në pronësi realizohet dhe vërtetohet me dokumentin Unik që është “Aktim i marrjes së tokës në pronësi”, të cilin ankuesit e disponojnë, dhe për aq kohe sa ky akt nuk është shfuqizuar apo shpallur i pavlefshëm ligjërisht, nuk ka pengesë ligjore për përcjelljen për regjistrim dhe më pas regjistrimin e atyre titujve të pronësisë në regjistrat përkatës të ZVRPP, Krujë.***

Në lidhje me trajtimin e kësaj ankese kemi marë në konsiderate legjislativonin sa më poshtë:

1. Ligjin nr. 7051, date 19.07.1991 *“Për Tokën”*, i ndryshuar,
2. Ligjin nr. 9948, date 07.07.2008 *“Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë”*.
3. Ligjin nr. 8454, date 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar.
4. VKM nr. 994, date 09.12.2015 *“Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”*, i ndryshuar,

Në përfundim, për të gjitha këto arsye, sa trajtuam më lart, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 21/b, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar,

REKOMANDOJMË:

“Marjen e masave nga ana e Bashkisë Krujë, për bashkëpunim në zbatimin e VKM-së Nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, si dhe përcjelljen për rregjistrim në ZVRPP Krujë të AMTP-ve nr. 303, 304, 305 të datës 25.07.1993, lëshuar nga Komisioni përkatës i ndarjes Tokës fshatit Borizanë, në emrat S.Sh (tashegimtari i R.Sh), B.Sh, N.Sh dhe R.Sh”.

Në lidhje me shqyrtimin që do të kryhet nga ana juaj Rekomandimit të derguar nga ana jone, konform nenit 19 të ligjit nr. 8454, date 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i

ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të realizohet brënda 30 diteve nga marja e kësaj shkrese.

Duke ju falenderuar paraprakisht për mirkuptimin dhe bashkepunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI